



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPËSTINA VUÇITRN

02 Nr. / Br 503/20

Nr. i fq. / Br. sf _____

Data: / Datum 01.07.2020

VUSHTARI - VUÇITRN



REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67, "f" dhe "g" të Statutit të Komunës, si dhe në bazë të propozimit të Drejtorisë për Ekonomi bujqësi pylltari dhe zhvillim rural, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M
PËR FORMIM TË KOMISIONIT PËR KORRJE-SHIRJE

1. Me këtë vendim formohet komisioni për përcjellje të fushatës së korrje-shirjeve në këtë përbërje:
 - 1.1 **Miran Halili**, kryesuese e shtabit (Drejtore për EBPZHR)
 - 1.2 **Rabije Zahiti**, anëtare (DEBPZHR)
 - 1.3 **Avdyl Feka**, anëtar (DEBPZHR)
 - 1.4 **Bajram Beqiri**, anëtar (DMSH)
 - 1.5 **Bajrush Gërgjaliu**, anëtar (DI)
2. Komisioni në përbërje të cekur në pikën paraprake të këtij vendimi do të përcjell përkatësisht monitoroj mbarëvajtjen e fushatës së korrje shirjeve në territorin e komunës së Vushtrisë si dhe të hartoj raport me shkrim për Kryetarin e Komunës lidhur me përfundimin e fushatës si dhe rendimentet e arritura nga korrje shirjet.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës

Vendimi i dërgohet:

- Drejtorit për Ekonomi Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural,
- Anëtarëve të komisionit dhe
- Arkivit të Sekretarisë.



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPËSTINA VUÇITRN	
02 Nr. / Br	506/20
Nr. i fq. / Br. st	
Data: / Datum	01.07.2020
VUSHTRI - VUÇITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67, "g" të Statutit të Komunës, neni 2 pika 3, neni 3 nënpika 1.1 dhe neni 5 pika 1 nënpikat 1.1, 1.2 dhe 1.3 të Rregullores (KKV) Nr. 04/20 për Ndarjen e bursave për Student, Nxënës dhe Shpërblimeve për Nxënës nr. prot. 01Nr. 95/20 datë 28.05.2020, si dhe në bazë të propozimit 10nr. 471/20 datë 17.06.2020 të Drejtorisë për Arsim, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Për nxënësit e arsimit fillor dhe të mesëm të Komunës së Vushtrrisë të cilët kanë arritur rezultate në gara të ndryshme me karakter komunal dhe republikan në v. 2020, iu ndahen mirënjohje dhe shpërblime në të holla si në vijim:
 - 1.1 Nxënësi **Ervin Segaq**, në kl. e IX-të të SHFMU''Gjergj Kastrioti Skënderbeu'' në Vushtri, shpërblehet me mirënjohje dhe njëqind e pesëdhjetë euro (150.00 €) për vendin e parë nga klasat e nënta, në Olimpiadën Matematike Komunale.
 - 1.2 Nxënësjë **Driana Haxhaj**, në kl. e IX-të në SHFMU''Migjeni''- në Stanoc i Epërm, shpërblehet me mirënjohje dhe njëqind e njëzet euro (120.00 €) për vendin e dytë nga klasat e nënta, në Olimpiadën Matematike Komunale.
 - 1.3 Nxënësjë **Lejla Istrefi**, në kl. e IX-të në SHFMU- Lummadhi- në Lumadh, shpërblehet me mirënjohje dhe njëqind euro (100.00 €) për vendin e tretë nga klasat e nënta, në Olimpiadën Matematike Komunale.
 - 1.4 Nxënësjë **Erina Mjeku**, nxënëse në kl. e X-të në Gjinnazin ''Eqrem Çabej'' në Vushtri, shpërblehet me mirënjohje dhe njëqind e pesëdhjetë euro (150.00 €) për vendin e parë nga klasat e dhjeta, në Olimpiadën Matematike Komunale.
 - 1.5 Nxënësi **Erblin Shabani** në kl. e X-të në Gjinnazin ''Eqrem Çabej'' në Vushtri, shpërblehet me mirënjohje dhe njëqind e njëzet euro (120.00 €) për vendin e dytë nga klasat e dhjeta, në Olimpiadën Matematike Komunale.
 - 1.6 Nxënësjë **Elmedina Lahu**, në kl. e XI-të në Gjinnazin ''Eqrem Çabej'' në Vushtri, shpërblehet me mirënjohje dhe njëqind e pesëdhjetë euro (150.00 €) për vendin e parë nga klasat e njëmbëdhjeta, në Olimpiadën Matematike Komunale.
 - 1.7 Nxënësjë **Donjeta Haxha**, në kl.XI-të në Gjinnazin'' Eqrem Çabej'' në Vushtri, shpërblehet me mirënjohje dhe njëqind e njëzet euro (120.00 €) për vendin e dytë nga klasat e njëmbëdhjeta, në Olimpiadën Matematike Komunale.


- 1.8 Nxënësi **Erdin Osmani**, në kl. e XII-të në Gjimnazin "Eqrem Çabej" në Vushtrri, shpërblehet me Mirënjohje dhe 150.00 (njëqind e pesëdhjetë) euro për vendin e parë nga klasat e dymbëdhjeta, në Olimpiadën Matematike Komunale.
- 1.9 Nxënësjja **Erza Asllani**, në kl. e XII-të në Gjimnazin "Eqrem Çabej" në Vushtrri, shpërblehet me mirënjohje dhe njëqind e njëzet euro (120.00 €) për vendin e dytë nga klasat e dymbëdhjeta, në Olimpiadën Matematike Komunale.
- 1.10 Nxënësjja **Ermira Halili**, në kl. e XII-të në Gjimnazin "Eqrem Çabej" në Vushtrri, shpërblehet me mirënjohje dhe njëqind euro (100.00 €) për vendin e tretë nga klasat e dymbëdhjeta, në Olimpiadën Matematike Komunale.
- 1.11 Nxënësjja **Gresa Jashari**, në kl. e XII-të në Gjimnazin "Eqrem Çabej" në Vushtrri, shpërblehet me mirënjohje dhe njëqind euro (100.00 €) për vendin e tretë nga klasat e dymbëdhjeta, në Olimpiadën Matematike Komunale.
- 1.12 Nxënësjja **Yllka Fejza**, në kl. e IX-të në SHFMU "Enver Hadri" në Smrekonicë, shpërblehet me mirënjohje dhe njëqind e pesëdhjetë euro (150.00 €) për vendin e parë për klasat e nënta, në garat komunale të fizikanëve të rinj.
- 1.13 Nxënësi **Dorart Ismajli**, në kl. e IX-të në SHFMU „Latif Berisha” në Dobërrlukë, shpërblehet me mirënjohje dhe njëqind e njëzet euro (120.00 €) për vendin e dytë për klasat e nënta, në garat komunale të fizikanëve të rinj.
- 1.14 Nxënësjja **Driana Haxhaj**, në kl. e IX-të në SHFMU-Lummadhi” Migjeni” në Stanoc i Epërm, shpërblehet me mirënjohje dhe njëqind euro (100.00 €) për vendin e tretë nga klasat e nënta, në garat komunale të fizikanëve të rinj.
- 1.15 Nxënësjja **Festina Avdiu**, në kl. e X-të në Gjimnazin "Eqrem Çabej" në Vushtrri, shpërblehet me mirënjohje dhe njëqind e pesëdhjetë euro (150.00 €) për vendin e parë për klasat e dhjeta, në garat komunale të fizikanëve të rinj.
- 1.16 Nxënësjja **Yllka Abazi**, nxënëse në kl. e X-të në Gjimnazin "Eqrem Çabej" në Vushtrri, shpërblehet me mirënjohje dhe njëqind e njëzet euro (120.00 €) për vendin e dytë për klasat e dhjeta, në garat komunale të fizikanëve të rinj.
- 1.17 Nxënësjja **Dafina Peci**, në kl. e X-të në Gjimnazin "Eqrem Çabej" në Vushtrri, shpërblehet me mirënjohje dhe njëqind e njëzet euro (120.00 €) për vendin e dytë për klasat e dhjeta, në garat komunale të fizikanëve të rinj.
- 1.18 Nxënësjja **Zana Ademi**, në kl. e X-të në Gjimnazin "Eqrem Çabej" në Vushtrri, shpërblehet me mirënjohje dhe njëqind euro (100.00 €) për vendin e tretë nga klasat e dhjeta, në garat komunale të fizikanëve të rinj.
- 1.19 Nxënësjja **Donjetë Haxha**, në kl. e XI-të në Gjimnazin "Eqrem Çabej" në Vushtrri, shpërblehet me mirënjohje dhe njëqind e pesëdhjetë euro (150.00 €) për vendin e parë për klasat e njëmbëdhjeta, në garat komunale të fizikanëve të rinj.
- 1.20 Nxënësi **Eron Merovci**, në kl. e XI-të në Gjimnazin "Eqrem Çabej" në Vushtrri, shpërblehet me mirënjohje dhe njëqind e njëzet euro (120.00 €) për vendin e dytë për klasat e njëmbëdhjeta, në garat komunale të fizikanëve të rinj.
- 1.21 Nxënësjja **Dijana Hoti**, në kl. e XI-të në Gjimnazin "Eqrem Çabej" në Vushtrri, shpërblehet me mirënjohje dhe njëqind euro (100.00 €) për vendin e tretë nga klasat e njëmbëdhjeta, në garat komunale të fizikanëve të rinj.
- 1.22 Nxënësjja **Floriana Beqiri**, në kl. e XII-të në Gjimnazin "Eqrem Çabej" në Vushtrri, shpërblehet me mirënjohje dhe dyqind e pesëdhjetë euro (250.00 €) për vendin e parë për klasat e dymbëdhjeta, në garat Komunale të fizikanëve të rinj dhe vendin e parë në garat Republikane të fizikanëve të rinj.

- 1.23 Nxënësi **Kushtrim Ibishi**, në kl. e XII-të në Gjimnazin "Eqrem Çabej" në Vushtri, shpërblehet me mirënjohje dhe njëqind e njëzet euro (120.00 €) për vendin e dytë për klasat e dymbëdhjeta, në garat komunale të fizikanëve të rinj.
2. Pagesat e mjeteve të cekura në pikën paraprake të këtij vendimi të bëhet nga buxheti i Drejtorisë për Arsim – subvencione dhe transfere, në llogarinë bankare të tyre (nëse kanë) apo njërit prind/kujdestarit të tyre.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Arsim.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.


Xhafer Tahiri
Kryetar i Komunës

Vendimi i dërgohet:

- Drejtorisë për Arsim
- Arkivit të Sekretarisë



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 11/09 datë 01.07.2020 dhe Nr. 01/10, datë 05.07.2020 për ndërmarrje të masave për parandalim të përhapjes së mëtejme të virusit COVID-19, Shtabi Emergjent i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 06.07.2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Me qëllim të zbatimit të vendimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 11/09 datë 01.07.2020 dhe Nr. 01/10, datë 05.07.2020 Komuna e Vushtrrisë të vazhdoj me ndërmarrje të masave të përcaktuara konform me kompetencat dhe përgjegjësitë ligjore, për parandalim të përhapjes së mëtejme të virusit COVID-19, përfshirë:
 - 1.1 Reduktimin e stafit të administratës së komunës dhe riorganizimin e punës e cila do të mund të kryhej pa pengesa me staf të reduktuar si dhe angazhimi i tyre aty ku është e mundur nga shtëpia (online). Drejtorët e drejtorive do të jenë bartës të zbatimit dhe mbikëqyrjes të kësaj mase. Secili drejtor do hartojnë një plan të riorganizimit dhe dorëzoj në zyrën e kryetarit dhe zyrën e personelit të komunës.
 - 1.2 Inspektorati i Komunës të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për mbikëqyrje të zbatimit të masave të përcaktuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës me Vendimet e datës 01 dhe 05 korrik 2020 lidhur me pandeminë COVID-19 në Kosovë.
 - 1.3 Nga Drejtoria për Inspektime kërkohet që të inicioj procedurën të Zyra e Personelit për shpallje të konkursit për dy inspektor sanitarë – me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta për aq kohë sa do të jetë e nevojshme për angazhim të tyre për mbikëqyrje të zbatimit të masave lidhur me pandeminë COVID-19.
 - 1.4 Në QKMF të angazhohet ekipi mjekësor mobil për punë në teren nga ora 07:00 deri në ora 24:00 për ofrim të shërbimeve mjekësore për rastet pozitive të infektuar me virusin COVID-19.
2. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRISË - OPŠTINA VUČITRAN	
02 Nr. / Br	531/20
Nr. i fq. / Br. sf	
Data: / Datum	07.07.2020
VUSHTRRI - VUČITRAN	



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. Lejohet pagesa e faturës numër 04 dt. 22.06.2020, në shumë prej 210.50 € (dyqindedhjetë euro e pesëdhjetë cent), me rastin e mbajtjes së akademisë solemne më 17 qershor 2020 për Ditën e Çlirimit të Vushtrisë, - ushqim tradicional për pjesëmarrës, përgatitur nga gratë e Shoqatës së Familjarëve të Martirëve në Vushtri.
2. Pagesa e shumës së cekur në pikën paraprake të këtij vendimi të bëhet nga buxheti i Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.




Xhafer Tahiri

Kryetari i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Arkivit të Sekretarisë.



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67 “g” të Statutit të Komunës, dhe nenin 7 të Rregullores Nr. prot. 95/20, dt.28.05.2020 për Ndarjen e Bursave për Studentët Nxënës dhe Shpërblime për Nxënës, si dhe në bazë të propozimit të Drejtorisë për Arsim 10Nr. 511/20 datë 07.07.2020, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Me këtë vendim caktohet shuma prej 400.00 € për një bursë si dhe numri i bursave sipas drejtimeve të studimeve që do të ndahet për student të rregullt të Komunës së Vushtrrisë, për vitin akademik 2019/2020, si vijon:

1. Bursa për drejtime deficitare

- 1.1 Fakulteti i SHMN – Matematikë - 3
- 1.2 Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës:
 - 1.2.1 Departamenti i Ndërtimtarisë - 3
 - 1.2.2 Departamenti i Arkitekturës - 3

2. Bursa për drejtime tjera

- 2.1 Fakulteti Filozofik - 3
- 2.2 Fakulteti i Edukimit:
 - 2.2.1 Programi fillor - 3
 - 2.2.2 Programi parafillor - 3
- 2.3 Fakulteti SHMN – 3
- 2.4 Fakulteti Filologjik - 3
- 2.5 Fakulteti Juridik - 3
- 2.6 Fakulteti Ekonomik - 3
- 2.7 Fakulteti Inxhinieri Elektrike dhe Kompjuterike - 3
- 2.8 Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike - 3
- 2.9 Fakulteti i Mjekësisë:
 - 2.9.1 Mjekësi e Përgjithshme – 2
 - 2.9.2 Stomatologji - 2
 - 2.9.3 Farmaci - 2
- 2.10 Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë - 3
- 2.11 Fakulteti i Shkencave të Aplikuara - 1

- 2.12 Fakulteti i Gjeoshkencave - 1
- 2.13 Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore - 2
- 2.14 Fakulteti i Arteve:
 - 2.14.1 Dega e Arteve Figurative - 2
 - 2.14.2 Dega e Arteve Dramatike - 2
 - 2.14.3 Dega e Arteve Muzikore -2
- 3. Zbatimin e këtij vendimi do ta bëj Drejtoria për Arsim konform Rregullores në fuqi për Ndarjen e Bursave për Studentët Nxënës dhe Shpërblime për Nxënës të Komunës së Vushtrrisë.
- 4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Xhafer Tahiri
Kryetar i Komunës

Vendimi i dërgohet:

- Drejtorisë për Arsim
- Arkivit të Sekretarisë.